



Republika e Kosoves  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti

## PROCESVERBAL nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Komunitete

Është mbajtur mbledhja e VII e rregullt e Komitetit për Komunitete të Komunës së Vitisë. Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Srdjan Djuric. Mbledhja është mbajtur në sallën e konferencës në objektin e ri të Komunës së Vitisë, është mbajtur me **24.07.2024** në orën **10h**. Në mbledhje ishin të pranishëm kryesuesi, z.Srdjan Djuric, znj.Kata Pala, znj.Vilsona Maliqi, z.Rifat Aniqi, z.Reshat Azizi dhe përfaqesuesja e OSBE-së, znj.Violeta Mehmeti.

**z.Srdjan Djuric:** Si fillim, dua t'ju përshëndes të gjithë të pranishmit dhe t'ju uroj një ditë të mbarë. Nëse jeni gati, ne mund të fillojmë. E hap seancën e shtatë të rregullt të Komitetit për Komunitete me këtë rend dite:

### RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Komunitete
2. Riparimi i ndriçimit publik në fshatin Binçë në rrugën “Don Nikoll Kaqorri”
3. Të ndryshme.

**z.Srdjan Djuric:** A pajtoheni me këtë rend dite? Po e hedh në votim rendin e ditës. Nëse jeni të gjithë dakord, konstatoj se rendi i ditës është miratuar dhe mund të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, mora informacion nga zonjusha Antoneta se, kryetari mori rekomandimet nga seanca e kaluar dhe se ai i zgjidhi të gjitha rekomandimet tona, përveç atij të fundit që lidhet me transportin për të sëmurët dhe të moshuarit. Kjo pikë është ende duke u zgjidhur. Pra, zonja Kate, pyetja juaj u zgjidh me sukses. Faleminderit z.kryetarit për të gjitha këto. Tani mund të kalojmë te pika e parë e rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procsverbalit nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Komunitete

**z.Srdjan Djuric:** A e kemi lexuar te gjithë procesverbalin dhe a jeni dakord me të? Nëse jeni për miratimin e tij, ju lutem ngrini dorën. Konstatoj se procesverbali i mbledhjes së kaluar është miratuar dhe mund të kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Pika e dytë e rendit të ditës:

## **2. Riparimi i ndriçimit publik ne fshatin Binçë, ne rrugën “ Don Nikoll Kaqorri”**

**z. Srdjan Djuric, kryesues i Komitetit për Komunitete:** Në atë rrugë tani meqe ka (nuk degjohet) ....gjatë vitit të kaluar ka ardhur deri te prishja në të gjithë poqat. Mendoj se janë 4-5, funksionon me sistemin e vjetër, pra nuk është led, por ndriçimi i vjetër janë ende poqa, kështu që vetëm duhet te zëvendësohen dhe kaq. Tani për tani e gjithë rruga është në errësirë. Gjatë vitit të fundit nuk mendoj se është ndonjë investim, zëvendësim i disa poqave. Rruga është shumë e frekuentuar edhe nga fëmijët edhe nga të rriturit. Është rrugë multietnike. Ne të gjithë jetojmë në atë rrugë, pra shqiptarët, serbët. Unë mendoj se nuk është një investim i madh dhe nuk është ndonjë problem. Pasi zotëria është nga Kabashi, e di ai, ajo rrugë është ura që të çon jo te Shusht, por në të djathtë përgjat rrugës së Razorit. Kjo urë e re që presidenti e punoi dy vite më parë. Nga ajo urë deri tek Razora e gjithë ajo pjesë është pa ndriçim. Ka disa rrugica ku njerëzit mund të marrin edhe një kthesë të gabuar, sepse nuk ka ndriçim. Kaq për këtë pikë, nuk kam asgjë të veçantë për të shtuar, vetëm se na duhen pak më pak pika të rendit të ditës për shkak të vapës, pushimeve e të tjera. A ka dikush ndonjë gjë për të shtuar?

**z.Reshat Azizi:** Përshendetje për kryesuesin, per juve. Po kuptoj tash ku është ajo rrugë, një distancë shumë e shkurtë. Unë e kisha lut sekretarinë që të bëjë kërkesë, kërkesë që ti dërgohet drejtorisë përkatëse, Drejtorisë për Shërbime Publike, se kjo nuk mundet me kalu menjëhere ndërrimi i poqeve. Qëllim i organizatës që ka marrë për ndriçim publik. Kompania ajo e bënë ndriçimin. Gjithë sistemi kalon nga sistemi i vjetër në sistemin eficient se i bënë ndërrimet e gjithë ati sistemi, nashti masi është distancë e shkurtë 4-5 shtylla.

**z.Srdjan Djuric:** Edhe me pak, unë mendoj që me dy do të zgjidhet problemi, distancë e shkurtë.

**z.Reshat Azizi:** Ajo mund me kalu shpejtë, mirëpo me ba një kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike le të ceket 3-4 shtylla, nuk ka më shumë, mos të jet peng për 4 shtylla.

**z.Srdjan Djuric:** E falenderoj nënkryetarin dhe do ta bëjmë një rekomandim, do t'ia dërgoj drejtorave. A ka dikush diçka të shtoj në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? Do të thotë mund të kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës. Të ndryshme.

Pika e tretë e rendit të ditës:

## **3. Të ndryshme**

**z.Srdjan Djuric:** A ka dikush propozim për seancen e ardhshme, çka do të duhet ose çfardo çoftë?

**z.Reshat Azizi:** Veç me met me shpresë që rekomandimin që e kemi ba nga mbledhja e gjashtë ta shohim sa është realizu. Gushti është pushim. Mundet me qenë edhe një pikë e rendit të ditës me kqyrë se sa është realizu.

**z.Srdjan Djuric:** Deri tani është realizuar.

**z.Reshat Azizi:** Pjeserisht. Plotësisht ta dim se sa, se tash është korriku. Gushti është pushim. Ashtu kështu s'kemi takim deri në shtator, 2 muaj ose e kryen... Deri në shtator ta shohim se a është realizu naj njo prej qetyne rekomandimeve s'paku. Tash në gusht është festa në Letnicë. Unë jam i angazhuar si ndihmës. Do të interesohem ta shoh se a ka dhane ndokush ndihmë atyre të shkretëve a jo. Nëse ka edhe naj pikë tjetër, por kjo mund me pas edhe 3 pika edhe 4 pika, veç ta shohim, ta dimi informatën, së paku në shtator. Ta dimë informatën se deri ku kemi mrrri. Se mdoket se brenga kryesore e komuniteteve është kjo, komuniteti kroat.

**z.Srdjan Djuric:** Nëse nuk ka askush asgje ta mbyllim, e perfundojm mbledhjen. Ju dëshiroj të gjithve një pushim të mirë në muajin e ardhshem. Pushoni mirë!

Mbledhja përfundoj në 10:30 min

**Procesmbajtes:**  
**znj.Antoneta Palja**

---

**Kryesuesi i Komitetit për Komunitete**  
**z.Srdjan Djuric**

---